



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. 25/2025

Data: 27 mars, 2025. Ora: 16:00

Vendi: KQZ/ Prishtinë

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Zëvendësimi i të zgjedhurve që kanë hequr dorë nga pozita e deputetit

**3. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës,
të mbajtura 9 shkurt 2025**

4.Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Po e hapi mbledhjen e 25, tha në fillim z. Radoniqi me pikën “e zëvendësimeve të deputetëve”, dhe certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura 9 shkurt 2025. Alban Krasniqi, arsyetoi shqyrtimin e tij, pse KQZ nuk duhet t’i bëjë zëvendësimet. Ndërsa, kryetari Radoniqi tha se, është një praktikë në të kaluarën që para certifikimit është bërë tërheqja e kandidatit, është zëvendësuar, dhe pastaj është certifikuar me të zëvendësuarin...

Alban Krasniqi tha se, fokusi duhet të jetë te certifikimi, ndërsa Ilir Gashi, tha se sipas ligjeve në fuqi duhet me dhanë dorëheqje për me u certifikua, dhe kemi disa shkresa... Janë dy kategori: ekzekutivi, dhe mandatet lokale, e që ata duhet të deklarojnë dorëheqjet e tyre, e ne të ecim tutje...

Sami Hamiti: Tre, duket janë kryetar komunash, e ata duhet të japin dorëheqje, s’mund të mbajnë dy funksionet... **Sami Kurteshi:** Kjo, ka të bëjë edhe me pasaktësinë e ligjit. Kemi pasaktësi...! E kuptoj, një është ekzekutivi qendror dhe, pjesa e pushtetit lokal” kryetarët, nënkryetarët...por, ka edhe pasoja, e ato nuk janë të njëjta, dhe ne s’mund ti bëjmë zëvendësimet, pa i kryer procedurat. Ne, ende s’kemi mandat të deputetit... KQZ, e ka ba njoftimin, e lexova e kjo, ka të bëjë me anëtarët e Qeverisë, por kjo është bërë duke e cituar një nen, por jo edhe nenet tjera: kur përfundon mandati, si përfundon...? Ai, citoi disa nene, si arsyetime ligjore...

Diskutuan më tej: Sami Hamiti, Arianit Elshani, i cili përmendi zgjedhjet lokale të vitit 2021 kur tha se para certifikimit janë pranue dorëheqjet, dhe se KQZ nuk ka nevojë të marrë vendim: aktet e dorëheqjeve të potencohen si njoftim, dhe se me kënd zëvendësohen...

Kreshnik Radoniqi: Jemi duke i zëvendësuar me personat e radhës, dhe e certifikojmë rezultatin me “peronat e ri”...

Me 10 vota për, 1 abstenim (Alban Krasniqi), miratohet rendi i ditës.

2. Zëvendësimi i të zgjedhurve që kanë hequr dorë nga pozita e deputetit:

Kreshnik Radoniqi: I kemi këto tri kërkesa që nuk kërkojnë të certifikohen: Gazmend Muhaxheri, kryetar i komunës në Pejë, Imri Ahmeti, kryetar i komunës në Lipjan, dhe Bedri Hamza që ka hequr dorë nga marrja e mandatit.

Sipas verifikimeve të bëra nga Sekretariati, z. Gazmend Muhaxheri, zëvendësohet me Arben Gashin, ndërsa Imri Ahmeti zëvendësohet me z. Paris Guri dhe Bedri Hamza me z. Rashit Çalaj.

S'ërih, u shqyrtua ky veprim nga: Alban Krasniqi, i cili tha të shpjegohet se a po marrim vendim, apo vetëm ky është njoftim, Ilir Gashi, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani.

3. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura 9 shkurt 2025:

Kreshnik Radoniqi:

Lidhur me certifikimin e rezultatit përfundimtar:

- 1.** Lëvizja "Vetëvendosje!": 42.30%
- 2.** PDK: 20.95%
- 3.** LDK: 18.27%
- 4.** AAK/Nisma: 7.06%
- 5.** Lista Serbska: 4.26%
- 6.** Koalicini për Familje: 2.13%
- 7.** KDTP: 0.51%
- 8.** IRDK: 0.50%
- 9.** Nova Demokratska Stranka: 0.44%
- 10.** Za sllopodu Pravde i Opsatanak: 0. 44%
- 11.** Koalicija Vakati: 0.37%
- 12.** Serpska Demokratija: 0.35%
- 13.** Partia Liberale Egjiptiane: 0. 35%
- 14.** Socialdemokratska Unija: 0.32%
- 15.** Partia e Ashkalinjve për Integrim: 0.23%
- 16.** PDAK/LPB: 0.22%
- 17.** Serpski Narodni Pokret: 0.20%
- 18.** Jerilini Hareket Partisi: 0.19%
- 19.** Jedinstvena Goranska Partija: 0.18%
- 20.** Nasha Boshnjacka Koalicija: 0. 17%
- 21.** Partia Rome e Bashkuar e Kosovës: 0.14%
- 22.** Fjala: 0.10%

- 23.** Kosova Adalet Turk Partisi: 0.7%
 - 24.** Partia Balli Demokrat Shqiptar: 0.7%
 - 25.** GINP: 0.07%
 - 26.** PKS: 0.05%
 - 27.** ORK: 0.04%
 - 28.** “Fatmir Bytyqi: 0.02%.
-

Në vazhdim, kryetari Radoniqi, lexoi me radhë kandidatët të cilët, kanë fituar ulëse në Parlamentin e Kosovës në zgjedhjet e 9 shkurtit, 2025.

Sami Kurteshi, tha se LVV ka kërkuar anulimin e votave me Postë, dhe gjykata Supreme nuk e ka miratuar kërkesën tonë, dhe ne do ta dërgojmë edhe në Gjykatën Kushtetuese. Po e informoj KQZ, dhe opinionin se deri sa ta kemi vendimin e Kushtetueses, unë nuk mund ta votojë certifikimin e rezultateve.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura 9 shkurt 2025 ?

Me 9 vota për, dy kundër (Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi), certifikohet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve qendrore të 9 shkurtit, 2025.

4. Të ndryshme!